



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E SHENDETESISE DHE MBROJTJES SOCIALE
OPERATORI I SHERBIMEVE TE KUJDESIT SHENDETESOR
Drejtoria e Sherbimit Spitalor Has

Krume me 11/12/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontrates – Sherbim

PER
ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER
KUALIFIKIM

(Ky procesverbal eshte per efekt publikimi bashke me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURES: “Sherbime ngrohje me pelet druri per Spitalin Has” *Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj*. REF-90337-12-11-2023

KODI PERKATES NE FJALORIN E PERBASHKET TE PROKURIMIT (CPV): 71314310-8 Sherbime per ngrohje te ndertesave.

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,250,000 (dy milion e dy qind e pese dhjete mije) leke pa tvsh.

Ne baze te nenit 21, pika 2, te Ligjit nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Has ka hartuar procesverbalin per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve per kualifikim per proceduren e sipercituar, me permbajtjen si me poshte:

I. KRITERET E VEÇANTA TE KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet te dorezoje:

a. *Formularin e Ofertes, sipas Shtojces 1;*

b. *Formulari i Sigurimit te Ofertes sipas Shtojces 3; Shuma e kerkuar e sigurimit te ofertes eshte 45,000 (dy zete e pese mije) leke.*

c. *Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces 9;*

Argumentimi: Kerkesat e mesiperme bazohen ne nenet 76, 82 dhe 83 te LPP, nenit 26, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet te dorezoje:

2.1. *Pershtatshmeria per te kryer veprimtarine profesionale (nese eshte e aplikueshme): Kjo pike plotesohet me paraqitjen e Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit te operatorit ekonomik ne ditën e hapjes se Ofertes, sipas Shtojces 9.*

Argumentimi: Kerkesa e mesiperme bazohet ne nenin 77, pika 1/a dhe 2, te LPP, nenit 40, pika 5, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Per te provuar se operatorët ekonomike kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare (2020, 2021, 2022) ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar të jetë në një vlerë jo më të vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet, leshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhezimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

2.2.2 Kopje të certifikuar të bilanceve të dy viteve të fundit (2021, 2022) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilanci duhet të shoqërohet *edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjor ose shoqëri audituese* Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatoreve ekonomike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zoterojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues për gatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhezimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabel, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhezimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji”.

2.3 Kapacitetet teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më pak se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (*vlera e pritshme e kontratave*) ose 900,000 (nente qind mijë) leke pa tvsh.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomike duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shihen vlera,

afati i perfundimit te kontrates dhe fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

- b) per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet te paraqese fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

Argumentimi: Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", nenit 40/4, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten, prandaj eshte kerkuar qe furnizimet e meparshme te ngjashme te jene ne vleren jo me pak se 40 % te vleres se fondit limit, qe eshte brenda vleres kufi te percaktuar ne nenin e sipercituar. Percaktimi i vleres se kerkuar per kontratat e ngjashme argumentohet si me poshte:

Percaktimi i vleres se kerkuar per kontratat e ngjashme eshte vendosur brenda kufirit te vleres te percaktuar ne rregullat e prokurimit publik dhe i sherben AK per te treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kane realizuar kontrata te ngjashme me objektin qe prokurohet, ne vlere jo me te vogel se 40 % te fondit limit, ne afat, me cilesi dhe rrit besueshmerine mbi pervojen qe ka ofertuesi ne treg. Pervoja e ngjashme konsiderohet si kriter thellesor dhe si rrjedhim operatoret ekonomike duhet te paraqesin deshmi te tilla si referenca/fatura tatimore, per te provuar kryerjen e tyre qofte me sektorin privat dhe ate publik.

2.3.2 Operatori ekonomik/ofertuesi duhet te paraqesi Licensen profesionale te Shoqerise duke deshmuar qe zoteron keto kategori lidhur me zoterimin e puneve te kontrates: kodi III.2.B "GRUMBULLIM, RUAJTJE DHE TRANSPORTIMI I LENDEVE TE DRURIT DJEGESEURBANE (PELLET)" leshuar nga QKL.

Argumentimi: Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", nenit 40, pika 5, germa a, te VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", si dhe bazuar ne Ligjin Nr.10 081, date 23.2.2009 "*Per Licencat, Autorizimet dhe Lejet Ne Republiken E Shqiperise*", *Shtojce e ligjit "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise"*.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te deklaroje ne formularin e vetedeklarimit se ka 1 (nje) cope kaldaje me pellet (me fuqi 480-500 KW) (te dhenat jane tek specifikimet teknike). Operatori ekonomik qe te kualifikohet duhet te provoje me dokumenta qe te kete gjendje 1 (nje) bruciator me pellet (karakteristikat teknike jane tek specifikimet teknike). Ofertuesi duhet te paraqese deklarate nga administrator i shoqerise qe kaldaja dhe dejegesi (bruciatori) te propozuara nuk jane te angazhuara ne ndonje kontrate tjeter. Paisjet teknike (kaldaje dhe djegesi/bruciatori) duhet te jete ne pronesi ose me kontrata qiraje noteriale. Per paisjet teknike ne pronesi, duhet te paraqitet akt zhdoganimi ose kontrate shit-blerje noteriale. Per paisjet teknike te mara me qera duhet te paraqiten kontrate qeraje noteriale e shoqeruar me dokumentin e pronesise se qiradhenesit (kontrate shit-blerje ose akt zhdoganimi).

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qellim qe ti sherbeje autoritetit kontraktor per njohjen e kapaciteteve dhe mundesise se OE per permbushjen me sukses te kontrates pra te garancise se furnizimit te mallit objekt prokurimi ne perputhje me nenin 40, pika 8, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik".

2.3.4 Operatori ekonomik duhet te paraqese "Certifikate konformiteti" per kaldajat, e leshuar nga shoqeri e licensuar. Per te vertetuar kete duhet te shoqerohet me Certifikate Akreditimi te leshuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit bashke me Akt miratimin e MIE ne emer te shoqerise qe certifikon kaldajat.

Argumentimi: Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", nenin 44, pika 3.4 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" Me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne se Certifikatat perkatese qe i mundeson Autoritetit Kontraktor per te verifikuar dhe krijuar besimin qe OE ofertues eshte ne gjendje te realizoje punen/sherbimin ne menyre cilesore qe parashikohen nga legjislacioni ne fuqi per kryerjen e sherbimeve, objekt i kontrates, te leshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet te jete i çertifikuar me ISO 9001:2015 (ose e perditesuar) mbi “Sistemet e menaxhimit te cilesise”, si dhe ISO 14001:2015 ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit te ambjentit” te leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise (te perkthyer dhe noterizuar).

Argumentimi: Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 79, “Standardet e sigurimit te cilesise” te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, dhe nenin 40 pika 5, te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Per vet natyren e veçante, vendndodhjes dhe permasat e objektit te kontrates qe do te prokurohet, eshte e rendesishme qe operoret te permbushin kontraten me standardet e kerkuara te cilesise. Sistemi i menaxhimit te cilesise, eshte standart qe çdo subjekt juridik apo privat e ka qellim ne arritjen e suksesit. Kjo çertifikate lidhet ngushtesisht me objektin e kontrates persa kohe do te pronohen dhe i sherben autoritetit kontraktor per njohjen e kapaciteteve te operatoreve ekonomike dhe te mundesise se tyre per permbushjen e plote te kontrates. Referuar ne nenin 79 te ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund te kerkoje certifikata, te leshuara nga organe te pavarura, qe vertetojne pajtueshmerine e kandidatit ose te ofertuesit me standardet e kerkuara te cilesise, perfshire edhe standardet per menaxhimin e mjedisit, shendetit dhe sigurise ne pune. Eshte nje standart nderkombetare i dedikuar per sistemet e menaxhimit te cilesise, i cili pershkruan nje kornize ne permiresimin e cilesise per çdo organizate qe kerkon te ofroje produkte dhe sherbime konform kerkesave dhe pritshmerise se klienteve/paleve te interesuara ne menyre me efektive te mundshme. Nder te tjera ky standart harmonizohet me objektivat dhe planet e Spitalit Bashkiak Has ne rritjen gjithnje e me shume te cilesise ne punet e perditshme dhe parafrimin me proçedurat e ngjashme me vendet e tjera te zhvilluara.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te deklaroje ne formularin e vetedeklarimit se ka 1 (nje) mjet Kamioncine me vinc me kapacitet mbajtes jo me te vogel se 3 ton.

Mjeti	Sasia	Gjendja
Makine transporti veteshkarkuese me vinc me kapacitet mbajtes jo me te vogel se 3 ton.	1 cope	Pronesi ose me qera

Ne cdo rast perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, qe te dorezoje dokumentat provuese per vetedeklarimet ne formularin permbledhes te vetedeklarimit si me poshte:

- a. Per mjetin ne pronesi duhet te paraqitet: a) dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronesise); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshem); e) çertifikate per transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b. Per mjetin e deklaruar me qera duhet te paraqitet: a) kontrata perkatese noteriale e qerases e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithete periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi b) dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (akti i pronesise) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshem); e) çertifikate per transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

Argumentimi: Kerkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikes 4, te Nenit te 77, te Ligjit Nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 40, pika 5, germa ”ç” te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kerkesave, Operoret ekonomike duhet te deshmojne qe kane mjetet e pajisjet teknike, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, qe kane ne dispozicion apo qe mund t’u vihen ne dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontrates objekt prokurimi. Dokumentacioni shoqerues i kerkuar per makinerite, provon certifikimin ligjor dhe teknik te mjeteve te disponuara nepermjet Kontrates se Shtitjes apo Kontrates se Qirase. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se furnizimi do te realizohen me cilesi, siguri dhe ne respektim te Grafikut te furnizimit (i cili do te publikohet se bashku me Dokumentat e Tenderit).

2.3.7 Operoret Ekonomike pjesemarres duhet te deklarone ne fomularin e vetedeklarimit se ka te punesuar minimalisht 4 punonjes te thjeshte.

Ne cdo rast perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afatit te ankimimit, autoriteti enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, qe te dorezoje dokumentat provuese per vetedeklarimet ne formularin permbledhes te vetedeklarimit si me poshte: Kontrata e punes (e vlefshme)

Argumentimi: per pikat 2.3.3 ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, te VKM nr. 285, date 19.05.2021, “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, me ane te ketij kriteri kerkohet qe operoret ekonomike te deshmojne qe kane fuqine punetore te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, qe ka ne dispozicion apo qe mund t’i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

a) Te kete gjendje 1(nje) cope kaldaja me pellet (me fuqi 480 – 500 KW) me keto te dhena:

○ Tipi	350/440
○ Fuqia min/max e punes	392 - 530 kw
○ Fuqia termike nominale	500 kw
○ Fuqia termike e kthyer	459 kw
○ tensioni i punes (elektrik)	380 v
○ Fuqia motorrike	1100 W
○ Rendimenti	87 %
○ Presioni i ujit	1,5 - 3,8 bar
○ Lartesia	2750 mm
○ Gjatesia	2180 mm
○ Gjeresia	1720 mm
○ Pesha	1855 kg
○ Kapaciteti i ditor i silozit	1,5 m ³
○ Silloz	15 ton

b) Te kete gjendje 1(nje) bruciator me pellet me keto karakteristika teknike:

○ modeli	BP500 kw
○ fuqia min/max ne ke	400-550 kw
○ tensioni i punes (elektrik)	220 V
○ fuqia e motorit te ventilatorit	190 W
○ Kandelet e ndezjes 2 cope	750 W
○ Rendimenti	85 %
○ dimensionet	360 x 420 x 1200 mm
○ shneku me diameter	110 mm
○ fuqia e motorit te shnekut	180 W
○ dimensionet tubit te shkarkimit	75 mm

Peleti duhet te jete ahu cilesia e pare. Analizat e peletit duhet te jene nga laborator i akredituar, jo me shume se 1 vit, ne momentin e dorezimit te mallit pasi eshte lidhur kontrata me OE-ne fituese. Operatori ekonomik duhet te dorezoje nje moster malli ditën e hapjes se procedures me te dhenat e kerkuara nga ana e AK-se.

Te dhenat teknike te pellet druri te jene si me poshte:

Nr	Treguesit	Njesia	Parametrat
1	Densiteti UNI EN 15203:2011	Kg/m ³	667.4
2	Fuqia kalorifike (neto) (Q) UNI EN 14918:2010	J.g t.q.	16.291
3	Mbetja mbas djegjes (hirit) UNI EN 14775:2010	% s.s.	0.1 – 0.2

4	Permbajtja e sqfurit UNI EN 15104:2011	% s.s.	<0.2
5	Ambalazhimi	Thase	15 kg
6	Lageshtira UNI EN 14774-2:2010	% t.q.	5.6
7	Fortesia UNI EN 15210-1:2010	% t.q.	<97
8	Gjatesia	Mm	30 – 40

Çdo furnizim duhet të shoqerohet me çertifikaten e cilesise, të peletit sipas kriterëve të percaktuara nga ana e AK.

Shenim:

- Çmimi i pelletit të kete të perlogaritur të gjitha detyrimet ligjore deri në dorezimin e tij në magazinat e Spitalit Has.
- Kapaciteti maksimal i një furnizimi është 30,000 kg pellet.
- Kaldaja duhet të jenë e pajisura me shnek dhe të shoqeruara me çertifikatat perkatese.
- Kaldaja duhet të jenë e pajisura me çertifikate konformiteti të Inspektimit të Pajisjeve nën presion me vatra zjarri.
- Operatori ekonomik i shpallur fitues duhet të bëjë montimin me shpenzimet e veta të paisjeve djegëse të pelletit dhe të bëjë mirëmbajtjen e tyre po me shpenzimet e veta, nga data e fillimit të kontratës deri në përfundimin e saj, si dhe trajnimin e personelit spitalor që do të punojë në këto kaldaja.

Specifikimet teknike hartohen nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose teresinë e elementeve me të rëndësishme perberese, që garantojnë cilësinë e kerkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kerkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Një nga detyrat funksionale të Drejtorisë së Sherbimit Spitalor Has është të kujdeset për ngrohjen e godinave të Spitalit Bashkiak Has. Për ushtrimin e detyrave funksionale stafi ka nevojë për pajisjen me lëndë djegëse pellet për të bërë të mundur ngrohjen e Godinës. Produktet e kerkuara duhet të jenë sa më cilësore, të përshatën teresisht specifikimeve teknike të kerkuara nga AK.

Afatet e levrimit

Afati për dorezimin e mallit është 12 muaj nga momenti i lidhjes së kontratës. Furnizimi do të bëhet në magazinën dhe godinat e Spitalit Bashkiak Has sipas grafikut të levrimit nga AK. Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorezimin e ofertave përcaktoi datën **26/12/2023, ora 11:00**.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt "Sherbime ngrohje me pellet druri për Spitalin Has", Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkelidhur këtij procesverballi:

- Dokumentat e tenderit

NJESIA E PROKURIMIT